

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Agim Ademi, me sekretaren juridike Hikmete Veliu - Pajaziti, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. A., nga Gj., të cilin sipas autorizimit e mbron avokat K. S., nga Gj., për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 185 par.5. lidhur me par.1 nën par. 1.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr. 105/2017, të datës 16.05.2017, të cilin e përfaqëson prokurori Shaban Spahiu, pas mbajtjes së seancës mbi pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, më datën 22.05.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. A., nga i ati Sh., dhe nëna Sh., e lindur B., i lindur me datë ... në Gj., ku edhe jeton rr. ... nr. ..., ... martuar, ... punësuar në biznesin f. “...” me seli në Gj., ka të kryer ..., i gjendjes së ...ekonomike, Shqiptar, Shtatetas e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë ... 2017 rreth orës ... ne Gj., në rrugën “...” para lokalit “...”, pas një zënke me fjalë me tani të dëmtuarin A. Sh. i moshës ... madhore nga Gj., të njëjtit i ka shkakuar lëndim të rëndë trupor në atë mënyrë që e godet me një kaqavidë në pjesën e majtë të kokës por që kaqavida i mbetet të dëmtuarit e ngulitur në kokë , e më pas i akuzuari ikë nga vendi i ngjarjes, ndërsa i dëmtuari dërgohet me urgjencë për ndimë

mjekstore në repartin emergjent në Spitalin Regjional në Gjilan e më pas në QKUK-ë në Prishtinë për trajtim të mëtejme mjekësorë, ashtu që nga goditjet e marra i dëmtuari pëson lëndim trupor me pasoja të përkohëshme për shënetin edhe atë plagë shpuese në tru në regjonin pronto – temporal majtas .

Me qka ka kryer veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 nenparagrafi 1.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata duke ju referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë dhe bazuar në nenet 3 ,41,45,62,69,75,76,83,114 të KPRK-së dhe nenit 233,365 453 të KPPRK-së.

E G J Y K O N

Të akuzuarin B. A., me dënim burgu në kohëzgjatje prej (1) një viti e (3) tre muaj , në të cilin dënim ka për t'iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës2017 e deri më datën2017, të cilin dënim do ta vuaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së Aktgjykimit .

Të akuzuarit B. A. i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i mjetit të kryerjes së veprës penale –kaqavidës .

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, e gjithë kjo në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.105/2017, të datës 16.05.2017, ndaj të akuzuarit B. A., nga Gj., për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda, Shaban Spahiu njoftoi kryertarin e trupit gjykues për marrjen e pëlqimit nga kryeprokurori për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë duke hequr dorë nga ndëgjimi i

dëshmitarëve dhe shtjellimi i provave materiale, ndërsa më pas shtoi se në seancën lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të mbajtur më date 22.05.2017, është bërë ricilesimi juridik i veprës penale nga vepra penale Vrasje në tentativë nëni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së në veprën penale Lëndimi i rëndë trupor, nga neni 189 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së ,njëkohësisht në këtë fazë të procedurës është bere edhe rregullimi i dispozitivi aktit akuzues ashtu që në dispozitivin e aktakuzës në rreshtin e tretë heqen fjalët” të njëjtin ka tentuar ta privoj nga jeta “si dhe në rreshtin e pestë hiqen fjalët “dhe vepra penale mbetet në tantativë” pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar . Prokuroria duke i pas parasysh shkresat e lëndës ka konstatuar se ë rastin konkret veprimet e të akuzuarit i pershtaten veprës penale ashtu siq është bërë ricilsimi – Lendimi i rëndë trupor. Lidhur me sanksionin penal pas negociimit me të pandehurin dhe mbrojtësin e tij i propozojmë Gjykatës që ti shqiptoj dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 vitë e 3 muaj, duke marre parasysh edhe rrethanat për zbutjen e dënimit ku si rrethan lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimi për veprën e kryer dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale, moshë relativisht e re si dhe fakti se me të dëmtuarin A. Sh. dhe familjen e tij janë pajtuar çka këtë e konfirmon përfaqësuesja ligjore (nëna e tij), e cila sa i përket masës së dënimit i ka propozuar Gjykatës një dënim më të butë. Andaj i propozojë Gjykatës që marrëveshjen si të tillë ta aprovojë.

Perfaqësuesja ligjore e të dëmtuarit të mitur A. Sh. – nëna e tij B. Sh. si dhe vet i dëmtuari nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale kundër të akuzuarit si dhe nuk kanë ushtruar kërkesë pasurore juridike .

Mbrojtësi me autorizim i të akuzuarit B. A. , avokat K. S., ka njoftuar se pas paraqitjes së kërkesës për marrëveshjen për pranimin e fajësisë me prokurorin e shtetit , kemi arritur marrëveshje në konsultim me të pandehurin B. A. , duke i njoftuar lidhur me benefitet dhe pasojat e marrëveshjes. Po ashtu jemi dakorduar edhe lidhur me sanksionin penal, por konsideroj se duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese e që janë në anën e te pandehurit sikur fakti se i njëjti e ka pranuar fajesin, gjendja shendetesore e te dëmtuarit fatmirësisht është përmirësuar se nga momenti i ndodhjes se ngjarjes familjaret e te pandehurit janë interesuar maksimalisht per gjendjen shendetesore e te dëmtuarit edhe duke e vizituar ne QKUK-ë por edhe ne shtëpi , se raportet mes dy familjeve janë të mira ,premtimi i te pandehurit se në të ardhmen nuk do te kryej vepra të tjera si dhe moshën relativisht të re .Andaj duke i pas parasysh këto rrethana lehtësuese dhe ne zbatim të nenit 76 te KPRK-së të pandehurit ti shqiptohet denim sikrse në paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 te nenit te përmendur më lartë.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke e njoftuar të akuzuarin me të

drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se këtë marrëveshje e ka bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njejtë marrëveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari B. A. e ka kryer veprën penale Lëndimi i rëndë trupor , nga neni 189 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.

Në seancën për pranimin e fajësisë prokurori i shtetit , i pandehuri dhe mbrojtësi i tij janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që Gjykata duke e aprovuar një propozim të tillë nga marrëveshja, të akzuarit B. A. i shqiptoj dënim burgu efektiv në kohëzgjatje prej (1) një viti e (3) tre muajë, duke ju llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.04.2017 e deri më datën 22.05.2017, të cilin dënim do ta vuaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së Aktgjykimit .

Vendimi mbi dënimin plotësues konfiskimin e mjetit të kryerjes së veprës penale – kaqavidës është bazuar në nenin 69 par.1 ë KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 453 të KPPRK-ës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 114/2017, të datës 22.05.2017**

**Sekretarja juridike,
Hikmete Veliu - Pajaziti**

**Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi**

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.